- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

---

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

## Shtojca 2.

*[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]*

### FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE<sup>5</sup>

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;

---

<sup>5</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:**

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

---

**Shtojca 3.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )*

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

### Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (4 x 5)
1.1	FV. Platfome Qendrore Menaxhimi per Kontroll Aksesit	cope	1		
1.2	FV. Licence e perhershme per perdorues Access Control	cope	1		
1.3	FV. Licence e perhershme per perdorues Time Attendance	cope	1		
1.4	FV. Central Akses Kontrolli	cope	8		
1.5	FV. Lexues RFID	cope	16		
1.6	FV. Kamera IP AI	cope	10		
1.7	FV. NVR AI	cope	2		
1.8	FV. Switch per CCTV	cope	2		
1.9	FV. Suport Montimi Kamera	cope	10		
1.10	FV. Kavoj LAN CAT6	ml	915		
1.11	FV. Monitor Interaktiv	cope	1		
1.12	FV. Mbajtëse për Monitor Interaktiv	cope	1		
1.13	FV. Transmetues Wireless Screen Share	cope	1		
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>					
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë</b> _____					

---

#### Shtojca 4.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*  
*[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 5.**

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**

---

## Shtojca 6.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

*b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

*c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### Specifikimet teknike

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1.1	FV. Platforme Qendrore Menaxhimi per Kontroll Aksesit	cope	1
1.2	FV. Licence e perhershme per perdorues Access Control	cope	1
1.3	FV. Licence e perhershme per perdorues Time Attendance	cope	1
1.4	FV. Central Akses Kontrolli	cope	8
1.5	FV. Lexues RFID	cope	16
1.6	FV. Kamera IP AI	cope	10
1.7	FV. NVR AI	cope	2
1.8	FV. Switch per CCTV	cope	2
1.9	FV. Suport Montimi Kamera	cope	10
1.10	FV. Kavo LAN CAT6	ml	915
1.11	FV. Monitor Interaktiv	cope	1
1.12	FV. Mbajtese per Monitor Interaktiv	cope	1
1.13	FV. Transmetues Wireless Screen Share	cope	1

#### 1.1 FV. Platforme Qendrore Menaxhimi per Kontroll Aksesit

- Zgjidhja duhet të jetë me licencë lifetime përdoruesi për minimumi 400 përdorues.
- Zgjidhja duhet të jetë me ndërfaqe grafike (GUI) të thjeshtë për përdorim dhe të mundësojë monitorim në kohë reale të të gjithë kontrollorëve të dyerve nga një qendër e vetme.
- Zgjidhja e ofruar duhet të përputhet me udhëzimet e GDPR, duke zbatuar mekanizma për maskimin e të dhënave, anonimizimin dhe kontrollin e aksesit, me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive të përdoruesve, si dhe sigurimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të privatësisë së të dhënave.
- Zgjidhja duhet të mundësojë menaxhimin e korporatave të mëdha me disa lokacione të largëta (multi-site).
- Zgjidhja duhet të mbështesë shpërndarjen automatike të modeleve të kredencialeve si: fytyrë (face), gjurmë gishti (fingerprint), kartë RFID, kod QR dhe PIN.
- Zgjidhja duhet të ofrojë funksion për numërimin e personave të pranishëm në ambient (head count).
- Zgjidhja duhet të mundësojë funksionet bazë të aksesit në dyer për përdoruesit.
- Zgjidhja duhet të regjistrojë ngjarjet e leximeve të kartave.
- Duhet të mundësojë konfigurimin e moduleve të ndryshme të softuerit në varësi të kërkesave funksionale.

- 
- Zgjidhja duhet të suportojë deri në 1,000 kontrollorë dyersh dhe deri në 10,000 përdorues në rrjet.
  - Zgjidhja duhet të mundësojë krijimin dhe administrimin e roleve dhe të drejtave të hyrjes (login roles & rights).
  - Zgjidhja duhet të lejojë konfigurimin e disa parametrave të profilit të përdoruesit për aplikim të njëkohshëm për më shumë se një përdorues.
  - Zgjidhja duhet të mundësojë përcaktimin e niveleve të operatorëve dhe aksesin e tyre në komponentët specifikë të sistemit për shikim, operim, ndryshim ose fshirje.
  - Zgjidhja duhet të lejojë që kontrollorët në rrjet të transmetojnë automatikisht të dhënat në server.
  - Duhet të ofrojë funksionin e mesazheve virtuale për publikimin e njoftimeve ditore, lajmeve dhe njoftimeve të brendshme.
  - Zgjidhja duhet të mundësojë integrim me SAP, ERP, HRM, Payroll, Tally, me mundësi integrimi përmes transferimit të bazave të të dhënave (database-to-database) ose përmes API-ve.
  - Duhet të mbështesë funksione për postim, rikthim, fshirje, rikuperim dhe backup të të dhënave.
  - Duhet të ketë funksion të backup-it automatik të bazës së të dhënave në orar të planifikuar.
  - Zgjidhja duhet të mbështesë integrimin me Microsoft Active Directory për importimin e përdoruesve në softuer.
  - Duhet të mundësojë dërgimin e njoftimeve SMS, E-mail dhe WhatsApp, duke integruar gateway të palëve të treta ose mail server.
  - Zgjidhja duhet të mbështesë protokollin BACNET për integrim të pandërprerë me sistemet e menaxhimit të ndërtesave (BMS) për shkëmbimin e ngjarjeve të dyerve dhe alarmit.
  - Duhet të ketë funksion të planifikimit automatik të dërgimit të raporteve me e-mail (E-mail Scheduler).
  - Zgjidhja duhet të gjenerojë raporte dhe grafikë analitikë me filtra të ndryshëm, modele të personalizuar raportimi, si dhe të mundësojë eksportimin e raporteve në formate Excel, Word, RPT, PDF, CSV dhe XML.

## **1.2 FV. Licence e perhershme per perdorues Access Control**

- Zgjidhja duhet të jetë me licencë lifetime përdoruesi për minimumi 400 përdorues
- Zgjidhja duhet të mbështesë mënyra të ndryshme aksesit si: fytyrë (Face), gjurmë gishti (Finger), kartë (Card), ose kombinim të secilës prej tyre.
- Zgjidhja duhet të ketë mundësinë e gjenerimit të njoftimeve me SMS dhe Email në rast të shkeljes së rregullave të aksesit, shkeljes së itinerarit të aksesit, detektimit të situatave të dhunës (Duress Detection), etj.

- Zgjidhja duhet të mbështesë autentikim me dy persona (Two-Person Authentication) për zona me nivel të lartë sigurie.
- Zgjidhja duhet të mbështesë funksionin Anti-Passback, duke ndaluar një hyrje të dytë në rast se nuk është regjistruar dalje për hyrjen e parë.
- Zgjidhja duhet të kontrollojë numrin e përdoruesve të lejuar në zona të caktuara, duke bllokuar aksesin kur kapaciteti maksimal është arritur.
- Zgjidhja duhet të parandalojë tailgating, duke shmangur futjen e personave të paautorizuar pas një personi të autorizuar.
- Zgjidhja duhet të mbështesë akses të bazuar në zona, kohë dhe përdorues (Zone-Based, Time-Based dhe User-Based Access).
- Zgjidhja duhet të mbështesë funksionin e alarmit të detyruar (Duress Alarm): kur mbajtësi i kartës detyrohet të hapë derën nën kërcënim, pajisja duhet të dërgojë alarm me prioritet të lartë në qendrën e monitorimit.
- Zgjidhja duhet të gjenerojë raporte të avancuara, përfshirë shkelje të rregullave të aksesit, Guard Tour, Anti-Passback, shkelje të itinerarit të aksesit, etj., dhe t'i eksportoje në formate PDF, Excel, Word, etj.

### 1.3 FV. Licence e perhershme per perdorues Time Attendance

- Zgjidhja duhet të jetë me licencë lifetime përdoruesi për minimumi 400 përdorues
- Zgjidhja duhet të mundësojë një gamë të gjerë funksionesh fleksibël si menaxhimin e shumë organizatave, politikave të vonesave në hyrje (Late-In), daljes së hershme (Early-Out), orëve shtesë (Overtime), mungesave (Absenteeism), pushimeve të shumëfishta, orareve të festave, si dhe regjistrimin dhe korrigjimin manual të hyrje-daljeve të punonjësve dhe përmbledhjen e pjesëmarrjes.
- Zgjidhja duhet të lejojë krijimin e disa degëve, departamenteve, seksioneve, pozicioneve, niveleve dhe kategorive të ndryshme të punonjësve.
- Zgjidhja duhet të përfshijë modul të plotë për menaxhimin e lejeve, duke mbuluar krijimin e llojeve të ndryshme të lejeve, menaxhimin e kërkesave dhe aprovimeve të tyre, balancimin e lejeve, grumbullimin dhe transferimin e lejeve të pashfrytëzuara, si dhe mundësinë e kompensimit financiar (encashment).
- Zgjidhja duhet të dërgojë njoftime automatike me SMS dhe/ose E-mail për ngjarje të paracaktuara si aplikimi për leje, aprovimi/refuzimi i lejeve, pjesëmarrja mujore, mungesa e regjistrimeve hyrje/dalje, etj.
- Zgjidhja duhet të ofrojë integrim përmes API-ve, lidhje database-to-database dhe modele të personalizuar eksporti të të dhënave.
- Zgjidhja duhet të mundësojë integrim të pandërprerë me sisteme të palëve të treta si Payroll, HRM, Tally, SAP, ERP dhe Active Directory.

- Zgjidhja duhet të lejojë krijimin e më shumë se 150 raporteve mbi pjesëmarrjen, lejet dhe turnet, me grafikë të personalizuar dhe filtra të shumtë; gjithashtu të mundësojë raporte të personalizuar sipas kërkesave të institucionit.
- Zgjidhja duhet të mbështesë deri në 900 turne dhe 900 orare, me deri në 32 turne për çdo orar.
- Zgjidhja duhet të menaxhojë ndërrime të vazhdueshme, përfshirë ato gjatë natës (overnight shifts).
- Duhet të monitorojë vonesat në hyrje dhe daljet e parakohshme në përputhje me orarin e turnit përkatës të punonjësit.
- Zgjidhja duhet të mundësojë llogaritjen e orëve shtesë (overtime) në bazë ditore, javore ose mujore.
- Zgjidhja duhet të mundësojë konvertimin e orëve shtesë në ditë pushimi kompensuese (Compensatory Off) ose në pagesë shtesë, sipas politikës së institucionit.
- Zgjidhja duhet të mundësojë krijimin e shumë turneve dhe orareve, me mundësi përcaktimi të kohës së pushimit, kohës së tolerancës (grace time), ditëve të pushimit, përsëritjeve periodike, etj., për menaxhimin efikas të stafit.
- Zgjidhja duhet të lejojë krijimin e të paktën deri në 20 grupeve të orareve të festive.
- Zgjidhja duhet të lejojë rregullime dhe korrigjime manuale të regjistrimeve të hyrje-daljeve, përfshirë orët shtesë, ditët kompensuese, vonesat dhe daljet e hershme.
- Zgjidhja duhet të ofrojë politika të personalizuar për çdo përdorues dhe periudhë, duke përfshirë Late-In, Early-Out, Overtime, C-OFF dhe mungesa.
- Zgjidhja duhet të gjenerojë automatikisht të dhënat e rregullimeve të periudhave të mëparshme dhe t'i përfshijë në llogaritjet e pagës për muajin aktual.
- Zgjidhja duhet të mundësojë gjenerimin e përmbledhjeve të pjesëmarrjes me të dhëna për punonjësit si pjesëmarrje, leje, ditë pushimi javore, pushime zyrtare, ndarë sipas organizatës, departamentit ose periudhave të përcaktuara nga përdoruesi.
- Zgjidhja duhet të ofrojë mundësi për deri në pesë nivele të autorizimit për miratimin e lejeve dhe udhëtimeve.

#### 1.4 FV. Central Akses Kontrolli

<b>Kërkesat minimale teknike</b>	
Kapaciteti i Përdoruesve	≥ 50,000
Numri max I dyerve:	≥ 2 dyer
Buffer i Eventeve	≥ 500,000
RS-485	Po
Ethernet	Po (10/100 Mbps)
PoE+	Po (IEEE 802.3 af/at)
Wi-Fi	Po (IEEE 802.11 b/g/n)
Wiegand	Po

Buton Dalje	Po (per cdo dere)
Sensori i Statusit të Dyerve	Po
Rele e Bllokimit të Derës	Po (30VDC min 2Ah, kontakte NO/NC/COM)
Ushqim per braven e deres	Po (12VDC min 0.5Ah)
Porta Aux In/Out	Po
Ndërfaqet e Lexuesit	RS-232 dhe Wiegand IN/OUT
Ushqim per Lexuesin	Po (12VDC min 0.25Ah)
Sinjalizime LED	Po
Detektimi i Ndërhyrjeve (Tamper)	Po
Integrimi	API për integrim me software
Furnizimi me energji	12 VDC / PoE+

### 1.5 FV. Lexues RFID

<b>Kërkesat minimale teknike</b>	
Kredencialet e suportuara	Karte RFID, Kod Pin, Aplikacion Mobile
Lloji i kartës	EM Proximity Card 125KHz
Bluetooth i integruar	Po
RS-232	Po
RS-485	Po
Wiegand	Po
Sinjalizim Led	Po
Sinjalizim Akustik “Buzzer”	Po
Zbulimi i ndërhyrjes “Tamper Detection”	Po
Rezistente ndaj kushteve atmosferike	IP65
Rezistente ndaj goditjeve	IK07
Detektimi i Ndërhyrjeve (Tamper)	Po
Sinjalizuesi Akustik (Buzzer)	Po

### 1.6 FV. Kamera IP AI

Te jete e njejta marke me NVR

#### Parametrat Teknike

Tipet & Nëntipet e Kamerave:	Dome/Turret
Rezolucioni i Figurës:	≥ 6MP (3296×1856)
Frame Rate:	min. 25/30fps @6MP
Tipi i Lentëve (“Lens Type”):	1/2.5" CMOS

---

Kendi i shikimit te lentes:	2.8mm ( $\geq 103^\circ$ )
Distanca ndriçimit IR/Light:	$\geq 20m$
Ndricimi minimal:	$\leq 0.008$ Lux
Shkalla e mbrojtjes:	$\geq$ IP67
Përmirësim Imazhi	True WDR (120dB), BLC, HLC, ROI
Reduktim zhurme	3D NR
Formati i Kompresimit të Videos:	H.265+/ H.264+ / H.265 / H.264 / MJPEG
Nderfaqje karte Micro SD	Po, deri ne 256GB
Mikrofon i Integruar	Po
Kompresimi Audio:	G.711A/G.711U
Pajtueshmëria e Sistemit:	ONVIF
Ushqimi:	PoE ose 12VDC

### Funksionalitetet AI

- AI (Zbulimi i Fytyrës – Face Detection): Te suportojë për detektimin e deri në 10 fytyra për kornizë (frame)
- AI – Heatmap: Gjenerimi i hartave të nxehtësisë për analizë të densitetit dhe lëvizjes
- Zbulimi i Ndërhyrjes në Kamera (Camera Tampering)
- Zbulimi i Njerëzve dhe Automjeteve (Human & Vehicle Recognition)
- Zbulimi i Zonës së Ndaluar / Zonës Sterile (SMD – Sterile Area Detection)
- Zbulimi i Kalimit të Vijës (Line Crossing Detection)
- Numërimi i Objekteve përmes Vijës (Line Object Counting)
- Numërimi i Objekteve brenda Zonës (Area Object Counting)
- Zbulimi i Qëndrimit të Zgjatur (Loitering Detection)
- 
- **Metadata e Gjeneruar nga Sistemi:**
  - Për Persona: Gjinia, Moshë, Drejtimi i lëvizjes, Kapelë, Syze, Maskë, Çantë shpine (Backpack), Çantë krahu (Shoulderbag), Lloji dhe ngjyra e veshjes së sipërme, Lloji dhe ngjyra e veshjes së poshtme, Fund/Fustan
  - Për Automjete (Vetura/Kamionë): Ngjyra, Tipi, Marka, Modeli
  - Për Mjete me 2 Rrota: Tipi (p.sh. motoçikletë, biçikletë, skuter)

Duhet të jetë në përputhje me kërkesat e NDAA (National Defense Authorization Act) dhe të mos përmbajë komponentë të ndaluar sipas legjislacionit përkatës.

### 1.7 FV. NVR AI 8CH

Kanalet e hyrjes video	$\geq 8$ kanale
Rezolucioni maksimal Out	$\geq 4K$ (3840 x 2160)
Kanalet e hyrjes së alarmit	$\geq 8$
Kanalet e daljes së alarmit	$\geq 4$
Te suportojë kamera me rezolucion	$\geq 12MP$

Network Bandwidth IN/OUT	≥ 80Mbps/80Mbps
Kompresimi Video	H.265S/H.265+/H.265/H264
Kompresimi Audio	G.711A/G.711U
Sistemi operativ	i integruar
Numri i HDD-ve të suportuar	≥ 1 x SATA (deri ne 10TB)
Porta LAN Ethernet (RJ-45)	≥ 2 (10/100/1000Mbps) with Fault Tolerance
Nderfaqe video ne dalje	min. 1 HDMI (4K@60Hz), min. 1 VGA
Porta USB	≥ 2
Nderfaqe RS-485	≥ 1
Protokollet te suportuara rrjeti	HTTP, HTTPS, TCP/IPv4/IPv6, RTSP, SMTP, NTP, DHCP, DNS, DDNS, SSL/TLS, UPnP, P2P
ONVIF	Po
Ushqimi “Power Supply”:	AC200-240V 50/60Hz

Te kete mundesi te lidhet me web browser Chrome, Firefox, Safari, etj.

Te kete Software per mobile per sistemet e operimit, IOS dhe Andoid

**Te suportojte funksionalitete AI Analitike:**

- Funksioni Face Recgniton për të paktën 6 kanale.
- Të ketë mundësinë e njohjes deri në 16 fytyra/sekondë ose më shumë.
- Modaliteti Avancuar i Njohjes së Fytyrës (Advanced Face Recognition Mode):  
Të suportojë deri në 2 kamera IPC jo-AI per te kryer detektim dhe njohje të fytyrës
- Zbulimi i Ndërhyrjes në Kamera (Camera Tampering)
- Klasifikim të Objekteve (Object Classification)
- Zbulimi i Kalimit të Vijës (Line Crossing)
- Zbulimi i Zonës Sterile (Sterile Area Detection)
- Monitorimi i Objekteve (Object Monitoring)
- Zbulimi i Qëndrimit të Zgjatur (Loitering Detection)
- Zbulimi i Parkimit të Paligjshëm (Illegal Parking)
- Zbulimi i Anomalive Audio (Audio Exception)
- Heat Map (Harta e Nxehtësisë)
- Numërimi i Objekteve përmes Vijës (Line Object Counting)
- Numërimi i Objekteve brenda Zonës (Area Object Counting)
- Kërkim Inteligjent (Smart Search)
- Njohje e Fytyrës (Face Recognition)
- LPR – Njohje e Targave (License Plate Recognition)
- Zbulimi i Grumbullimit të Turmës (Crowd Gathering)
- Zbulimi i Hyrjes së Personave (People Intrusion)

Duhet të jetë në përputhje me kërkesat e NDAA (National Defense Authorization Act) dhe të mos përmbajë komponentë të ndaluar sipas legjislacionit përkatës.

Te kete te perfshire HDD 8 TB per surveillance.

---

## 1.8 FV. Switch per CCTV

Nderfaqje rrjeti	≥ (8) Porta 10/100 Mbps Ethernet RJ45
POE	≥ (8) Porta POE 802.3af, 802.3at
Fuqia total PoE	≥ 120w
Tabela MAC Address:	≥ 2K
Standartet min. të suportuara:	IEEE802.3, IEEE802.3u, IEEE802.3ab, IEEE802.3x, IEEE802.3af, IEEE802.3a

## 1.9 FV. Suport Montimi Kamera

- Te suportoje per montimin e modelit te kameres.
- Te kete standarr min IP64

## 1.10 FV. Kavo LAN CAT6

- Lloji UTP
- Kategoria 6
- Konduktori ≤ 23AWG

## 1.11 FV. Monitor Interaktiv

### PANELI

Tipi "Type":	Tabelë interactive 85"
Pamja	16:9
Madhësia "Size":	Min 85"
Teknologjia "Technology":	Backlid LED, IPS, ose ekuivalent
Ndriçimi "Brightness":	Min 500 cd/m <sup>2</sup>
Kontrasti "Contrast":	Min 1000:1 ose më i mirë
Kontrasti Dinamik "Dynamic Contrast":	Min 5000:1 ose më i mirë
Rezolucioni "Resolution":	Min 4K Ultra-HD (3840 x 2160)
Këndi i shikimit "Viewing Angle":	178° / 178°
Frekuenca e Rifreskimit "Refresh Rate":	Min 60Hz
Cikli I jetës "Estimated Life Time":	Min 50'000 orë pune
Bokset "Speakers":	Min 2x40W Stereo
Webcam:	Min 48Mpx me mikrofon te integruar

### PREKJA / TOUCHSCREEN

Teknologjia e Prekjes "Touch Technology":	Me infra të kuqe
Pikat e prekjes "Touch Point":	Min 40 pika prekje njëkohësisht

Saktesia e lapsit/prekjes “Accuracy Pen/Touch”:	+/- 1mm
Response time - "Koha e përgjigjes"	min, <4ms
Mbrojtja e Sipërfaqes “Surface Protection”:	Min 5mm xham i temperuar,
Veglat e prekjes “Touch Tools”:	Gisht, laps
<b>SPECIFIKIMET E BORDIT</b>	
Madhësia e RAM “RAM Size”:	Min 8GB
Madhësia e Memorjes “Storage Size”:	Min 128GB
Sistemi Operativ “Operating System”:	Android 14 - upgradable
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
Portat Hyrëse “Input Ports”:	(3) HDMI (1) Audio 3.5mm (1) Mikrofon 3.5mm
Portat Dalëse “Output Ports”:	(1) HDMI Out (1) Audio 3.5mm (1) SPDIF Out
Portat Lidhese “Connectivity Ports”:	(1) RJ45 Ethernet LAN (1) RS232 Seriale (1) Wi-Fi Dual Band (2.4GHz & 5GHz)
Portat USB “USB Ports”:	Përpara (3) USB-A 3.0 (1) USB-C 3.1 (1) USB-B Touch-USB
<b>FUNKSIONALITETE</b>	
Prezantim i dokumentave (“Document Presentation”)	Po
Shenime mbi dokumentat (“Document Annotation”)	Po
Ndarja e Ekranit	Multi-screen, wireless screen-sharing
<b>AKSESORET</b>	
Aksesorët e Përfshirë “Included Accessories”:	(1) Kabëll fuqie (2) Lapsa interaktiv (1) Telekomandë me bateri (1) Mbajtëse Murale

---

## 1.12 FV. Mbajtese per Monitor Interaktiv

- Te jete e levizshme me rrota
- Te suportoje dimensionin e Monitorit Interaktiv te ofruar.
- Te suportoje peshen e Monitorit Interaktiv te ofruar.

## 1.13 FV. Transmetues Wireless Screen Share

- Rezolucion minimal i transmetimit: Full HD 1080p
- Distanca minimale e transmetimit:  $\geq 15$  m në ambient të brendshëm
- Të suportoje minimalisht sistemet operative: Windows, macOS, Android, iOS
- Lidhja me Laptop/Desktop USB
- Duhet të jetë pajisje hardware transmetuese (USB transmitter) për ndarjen wireless të ekranit nga laptop/desktop tek Monitori Interaktiv.
- Të jetë Plug & Play, të startojë automatikisht pas lidhjes në USB.
- Duhet të mundësojë prezantim direkt me shtypje butoni (one-click presentation)

**Shtojca 7.**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Kohe zgjatja</b>
1.1	FV. Platforme Qendrore Menaxhimi per Kontroll Aksesi	cope	1	20 ditë
1.2	FV. Licence e perhershme per perdorues Access Control	cope	1	20 ditë
1.3	FV. Licence e perhershme per perdorues Time Attendance	cope	1	20 ditë
1.4	FV. Central Akses Kontrolli	cope	8	20 ditë
1.5	FV. Lexues RFID	cope	16	20 ditë
1.6	FV. Kamera IP AI	cope	10	20 ditë
1.7	FV. NVR AI	cope	2	20 ditë
1.8	FV. Switch per CCTV	cope	2	20 ditë
1.9	FV. Suport Montimi Kamera	cope	10	20 ditë
1.10	FV. Kavo LAN CAT6	ml	915	20 ditë
1.11	FV. Monitor Interaktiv	cope	1	20 ditë
1.12	FV. Mbajtese per Monitor Interaktiv	cope	1	20 ditë
1.13	FV. Transmetues Wireless Screen Share	cope	1	20 ditë

---

## Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatesisht 59.467 (pesëdhjete e nënte mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

---

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006.

”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025).**

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruar ne organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar si kompani sipas standardeve ISO te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) **ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme); ). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, per menaxhimin e shërbimeve te teknologjise se informacionit (e vlefshme); ). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

**2.3.3** Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë Autorizim nga Prodhuesi / Distributori i autorizuar, për shitjen dhe shërbimin për të gjithë zërat objekt i këtij prokurimi. Autorizimi i Prodhuesit / Distributorit te autorizuar te përfshije te dhëna te plota me objekt dhe numer reference te procedures dhe detaje për kontaktin. Ne rast te paraqitjes se Autorizimeve te kërkuara nga Distributori i Autorizuar respektiv te vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit te autorizuar

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses te kontratës, duhet te kete te punesuar për të paktën muajin e fundit *(nga data e publikimit te njoftimit te kontrates)* dhe të disponojë si staf te tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

- a) Te pakten 1 (nje) Inxhinier në fushën e Elektronikës ose ekuivalente (per kete kriter te dorezohet diploma perkatese te pakten ne nivelin Bachelor);
- b) Te pakten 1 (nje) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin e Kontrollit të Aksesit (instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve) ose ekuivalente;
- c) Te pakten 1 (nje) Teknik të certifikuar nga prodhuesi për Sistemin CCTV (instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve) ose ekuivalente;
- d) Te paktën 1 (nje) specialist te certifikuar ITIL për menaxhimin e shërbimeve IT ose ekuivalente;

*Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat/diplomat perkatese te kualifikimit si*

---

dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperm.
- Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, per muajin e fundit;

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”

2.3.5 Per vleresimin e sakte te ofertes teknike, Operatori Ekonomik duhet te paraqese fizikisht, ne daten dhe oren e hapjes se ofertave moster te pajisjeve/komponenteve ne vijim:

Nr. Rendor	Pershkrimi
1.4	Central Akses Kontrolli
1.5	Lexues RFID
1.6	Kamera IP AI
1.7	NVR AI

Mosparaqitja e mostrave ose mosperputhja e parametrave teknik te tyre me specifikimet e kerkuara eshte kusht skualifikues.

Mostrat do jene konfidenciale per secilin operator ekonomik.

Mostrat do te dorezohen ne zyren e prokurimeve te Autoritetit Kontraktor ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave.

*Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -

E-mail:	----- -----
---------	----------------

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata
-----------

<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>				
<hr/>				
<hr/>				
<p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p>				

<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>				
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>				

<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlërësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.				
